

GJYKATA E APELIT

Numri i rastit: **PAKR Nr 456/15**

Data: **14 shtator 2016**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Roman Raab si Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtar raportues, gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro dhe gjyqtarja vendore e Gjykatës së Apelit Hava Haliti si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Adam Viplak, zyrtar ligjor i EULEX-it, si procesmbajtës,

Në rastin penal kundër

- 1. A.D.;**
- 2. B.D.;**
- 3. D.D.;**
- 4. S.D.;**
- 5. F.D.;**
- 6. J.D.;**
- 7. N.D.;**
- 8. Z.D.;**
- 9. S.S.;**
- 10. I.T.;**

Të akuzuar sipas aktakuzës PPS 88/11 me datë 6 nëntor 2013, parashtruar nga Prokurori i EULEX-it i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) me 8 nëntor 2013, prej së cilës dy pika të akuzës ishin ndarë për një procedurë të veçantë;

Gjykuar në shkallë të parë nga *Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktgjykimin P. Nr. 58/14*, e datës 27 maj 2015;

Duke vendosur në bazë të ankesave si në vijim, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P. Nr. 58/14 me datë 27 maj 2015

- **Ankesa e Prokurorit Special e parashtruar me datë 6 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës I.A. në emër të të pandehurit A.D., parashtruar me 6 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës S.I. në emër të të pandehurit B.D., parashtruar me 6 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës K.O. në emër të të pandehurit D.D., parashtruar me 5 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës R.M. në emër të të pandehurit S.D., parashtruar me 5 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës V.B. në emër të të pandehurit F.D., parashtruar me 3 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës M.S. në emër të të pandehurit J.D., parashtruar me 5 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës G.G.S. në emër të të pandehurit S.S., parashtruar me 7 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës B.M. në emër të të pandehurit N.D., parashtruar me 1 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës B.T. në emër të të pandehurit Z.D., parashtruar me 3 gusht 2015;**
- **Ankesat e avokatit mbrojtës A.Q. në emër të të pandehurit I.T., parashtruar me 5 gusht 2015;**

Duke pas shqyrtuar mocionin e Prokurorit të Shtetit të Apelit parashtruar me 28 tetor 2015;

Duke i pas mbajtur seancat me datat 16, 17 dhe 19 maj 2016;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur me datë 9 gusht dhe 14 shtator 2016;

Në bazë të Neneve 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPP”);

Lëshon si në vijim

AKTGJYKIM

Ankesat që prokurori i ka parashtruar me 6 gusht 2015,

Avokati mbrojtës A.Q. në emër të të pandehurit I.T. parashtruar me 5 gusht 2015,

Avokati mbrojtës G.G.-S. në emër të të pandehurit S.S. parashtruar me 7 gusht 2015,

Avokati mbrojtës B.T. në emër të të pandehurit Z.D. parashtruar me 3 gusht 2015,

Avokati mbrojtës M.S. në emër të të pandehurit J.D. parashtruar me 5 gusht 2015,

Avokati mbrojtës I.A. në emër të të pandehurit A.D. parashtruar me 6 gusht 2015,

Avokati mbrojtës S.I. në emër të të pandehurit B.D. parashtruar me 6 gusht 2015,

Avokati mbrojtës K.O. në emër të të pandehurit D.D. parashtruar me 5 gusht 2015,

Avokati mbrojtës R.M. në emër të të pandehurit S.D. parashtruar me 5 gusht 2015,

Avokati mbrojtës V.B. në emër të të pandehurit F.D. parashtruar me 3 gusht 2015,

Avokati mbrojtës B.M. në emër të të pandehurit N.D. parashtruar me 1 gusht 2015,

refuzohen si të pabazuara.

- I. Në bazë të Nenit 394 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 i KPP-së Aktgjykimi i gjykatës Themelore të Mitrovicës P 58/2014 e datës 27 maj 2015 është ndryshuar në dispozitiv.**

Vendimet e fajshme në pikat I dhe II të aktgjykimit të kundërshtuar përmes kësaj konfirmohen.

Në lidhje me të pandehurit S.S., I.T., Z.D. dhe J.D. mbi bazat e Nenit 81 paragrafi 1 i KPRK-së pikat I dhe II konsiderohen pjesë të veprës penale në vazhdim.

Pika III e Aktgjykimit të shkallës së parë do të ndryshohet si në vijim:

Në bazë të Nenit 31 dhe Nenit 152 paragrafi 1 i KPRK-së në lidhshmëri me Nenin 33 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lexuar së bashku me Nenin 45 paragrafi 1, Nenin 81 paragrafi 1 i KPRK-së të pandehurit janë dënuar si në vijim

S.S. me 7 (shtatë) vjet burgim,

I.T. me 6 (gjashtë) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim,

Z.D. me 6 (gjashtë) vjet burgim,

J.D. me 6 (gjashtë) vjet burgim,

Në bazë të Nenit 31 dhe Nenit 152 paragrafi 1 i KPRK-së në lidhshmëri me Nenin 33 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lexuar së bashku me Nenin 45 paragrafi 1, Nenin 75 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2, dhe Nenit 76 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 i KPRK-së, të pandehurit;

A.D. me 3 (tre) vjet burgim,

D.D. me 3 (tre) vjet burgim,

B.D. me 3 (tre) vjet burgim,

S.D. me 3 (tre) vjet burgim,

F.D. me 3 (tre) vjet burgim,

N.D. me 3 (tre) vjet burgim.

II. Vendimi i aktgjykimit të kundërshtuar në Pikën IV në lidhje me llogaritjen e periudhave të paraburgimit, ndryshohet si më poshtë:

Periudha e privimit të lirisë së S.S. nga data 23 maj 2013 deri me datë 31 maj 2013 gjersa në paraburgim, nga data 31 maj 2013 e deri me 19 dhjetor 2014 gjersa në arrest shtëpiak dhe nga data 27 maj 2015 e deri në dorëzimin me shkrim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit gjersa në paraburgim, do të llogaritet në dënimin me burgim të shqiptuar ndaj tij.

Periudha e privimit të lirisë së I.T. nga data 24 maj 2013 e deri me 31 maj 2013 gjersa në paraburgim, nga data 31 maj 2013 e deri me 19 dhjetor 2014 gjersa në arrest shtëpiak dhe nga data 27 maj 2015 e gjer në dorëzimin me shkrim të

Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit gjersa në paraburgim, do të llogaritet në dënimin me burgim të shqiptuar ndaj tij.

Periudha e privimit të lirisë së J.D. nga data 24 maj 2013 e deri me 31 maj 2013 gjersa në paraburgim, nga data 31 maj 2013 e deri me 19 dhjetor 2014 gjersa në arrest shtëpiak dhe nga data 27 maj 2015 e gjer në dorëzimin me shkrim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit gjersa në paraburgim, do të llogaritet në dënimin me burgim të shqiptuar ndaj tij.

Periudha e privimit të lirisë së Z.D. nga data 23 maj 2013 e deri me 31 maj 2013 gjersa në paraburgim, nga data 31 maj 2013 e deri me 19 dhjetor 2014 gjersa në arrest shtëpiak dhe nga data 27 maj 2015 e gjer në dorëzimin me shkrim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit gjersa në paraburgim, do të llogaritet në dënimin me burgim të shqiptuar ndaj tij.

III. Vendimi i aktgjykimit të kundërshtuar në Pikën 5 në lidhje me shpenzimet e procedurës penale ndryshohet si më poshtë:

Shpenzimet e procedurës penale do të reimbursehen pjesërisht nga J.D. në shumën e caktuar prej 500 Eurosh.

IV. Në pjesët e mbetura, aktgjykimi konfirmohet.

ARSYETIMI

I. SFONDI PROCEDURAL RELEVANT

A. Aktakuza

Me 08 nëntor 2013 Prokurori i EULEX-it i PSRK-së e parashtri aktakuzën nr PPS 88/11 me datë 6 nëntor 2013. Dy pikat e aktakuzës ishin ndarë për një procedurë të veçantë dhe atë si në vijim:

I. A.D., S.S., I.T., Z.D., F.D., N.D., S.D., D.D., B.D. dhe J.D. ishin akuzuar me veprën si në vijim:

Në cilësinë e tyre si pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe me anëtarët e tjerë deri më tani të pidentifikuar të UÇK-së, kanë dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B, dy civilë të burgosur në qendrën e paraburgimit në Likoc/Likovac, duke:

- I rrahur me grushta dhe shkopinj druri ;
- duke e detyruar Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B që ta rrahin njëri tjetrin;
- duke shtrënguar organet gjenitale të Dëshmitarit A me një mjet të hekurt dhe më pas duke e zvarritur atë në tokë me këtë mjet,

në Likoc/Likovac (Komuna Skenderaj/Serbicë), në një datë të pacaktuar në shtator 1998.

II. J.D., S.S., I.T., dhe Z.D. po ashtu ishin akuzuar në cilësinë e tyre si pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe me anëtarët e tjerë deri më tani të pidentifikuar të UÇK-së, në një numër të papërcaktuar rastesh kanë dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e Dëshmitarit A, një qytetar civil i burgosur në qendrën e paraburgimit në Likoc/Likovac, duke e rrahur atë me grushta dhe me shkopinj druri në pjesë të ndryshme të trupit, në Likoc/Likovac (Komuna Skenderaj/Serbicë), në disa data të papërcaktuara në gusht dhe shtator të vitit 1998.

Që të dyja këto pika të akuzës janë klasifikuar në aktakuzë si krime të luftës kundër popullatës civile.

B. Aktgjykimi

Shqyrtimi kryesor ka filluar me datë 27 qershor 2014 dhe ka përfunduar me 25 maj 2015. Shqyrtimi ka zgjatur për 23 ditë.

Rasti qe gjykuar në shkallë të parë nga *Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktgjykimin P. Nr. 58/14*, me datë 27 maj 2015, si në vijim:

I. A.D., B.D., D.D., S.D., F.D., J.D., N.D., Z.D., S.S., dhe I.T. janë gjetur *fajtor* në lidhje me veprimin si në vijim: se, gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në një datë të pacaktuar në shtator të vitit 1998, duke vepruar si anëtarë të UÇK-së , në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe me anëtarët e tjerë deri më tani të pidentifikuar të UÇK-së, kanë bërë shkelje të rëndë të Nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 sepse ata me

dashje kanë ushtruar dhunë, trajtim mizor, tortura dhe trajtim poshtërues ndaj Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B, dy civilë shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në qendrën e paraburgimit të UÇK-së në Likoc/Likovac (Komuna Skenderaj/Serbicë), të cilët nuk morën pjesë aktive në luftime, duke i rrahur ata me grushta dhe shkopinj druri, duke e urdhëruar Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B që ta rrahin njëri tjetrin, duke shtrënguar organet gjenitale të Dëshmitarit A me një mjet të hekurt, dhe në bazë të Nenit 33 Paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky veprim është klasifikuar:

si krim lufte sipas Nenit 31 dhe Neni 152, Paragrafi 1 dhe Paragrafi 2, Nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, dhe në shkelje të Nenit 4 Paragrafi 2 (a) i Protokollit Shtesë II (AP II) të Konventës në fjalë, dhe për këtë krim:

në bazë të Nenit 31 dhe Neni 152 Paragrafi 1 i KPRK-së dhe Neni 45 paragrafi 1 i KPRK-së, ndryshuar nga Neni 33 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe Neni 38 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) në formulimin e saj, siq ka hyrë në fuqi me 1 korrik 1977, që është mbajtur në fuqi nga Seksioni 1 paragrafi 1.1(b) i rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, **J.D., Z.D., S.S., dhe I.T. u dënuan si në vijim:**

- **S.S. me 7 (shtatë) vjet burgim;**
- **J.D. me 6 (gjashtë) vjet burgim;**
- **Z.D. me 6 (gjashtë) vjet burgim;**
- **I.T. me 6 (gjashtë) vjet burgim;**

Dhe në bazë të Nenit 31 dhe 152 paragrafi 1 dhe Neni 45 paragrafi 1 i KPRK-së ndryshuar nga Neni 33 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe Neni 38 paragrafët 1 dhe 2 të KPRSFJ-së në formulimin e saj, siq ka hyrë në fuqi me 1 korrik 1977 që është mbajtur në fuqi nga Seksioni 1 paragrafi 1.1 (b) i rregullores së UNMIK-ut 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999, dhe Neni 75 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 dhe Neni 76, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 i KPRK-së **A.D., B.D., D.D., S.D., F.D., dhe N.D. u dënuan si në vijim:**

- **A.D. me 3 (tre) vjet burgim;**
- **D.D. me 3 (tre) vjet burgim;**
- **B.D. me 3 (tre) vjet burgim;**
- **S.D. me 3 (tre) vjet burgim;**
- **F.D. me 3 (tre) vjet burgim;**
- **N.D. me 3 (tre) vjet burgim;**

II. **J.D., Z.D., S.S., dhe I.T.**, janë gjetur *fajtor* në lidhje me veprën penale si në vijim:

se gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në disa raste në gusht dhe shtator të vitit 1998, duke vepruar si pjesëtarë të UÇK-së, në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe me anëtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-së, kanë shkelur rëndë Nenin 3 të përbashkët të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, për shkak se ata me dashje kanë kryer dhunë, trajtim mizor, tortura dhe trajtim poshtëruës dhe degradues ndaj Dëshmitarit A, një civil shqiptar i Kosovës i paraburgosur në qendrën e paraburgimit të UÇK-së në Likoc/Likovac (Komuna Skenderaj/Serbicë), I cili nuk mori pjesë aktive në luftime, duke e rrahur atë me shkopinj druri dhe grushta në pjesë të ndryshme të trupit të tij, brenda qelisë së paraburgimit, dhe ky veprim, ishte klasifikuar:

në bazë të Nenit 33, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si krim lufte në vazhdim sipas Nenit 81, paragrafi 1, Neni 31, Neni 152, Paragrafi 1 dhe Paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 të KPRK-së, në shkëlqje të Nenit 4, paragrafi 2 (a) i AP II, dhe për këtë krim:

Dhe në bazë të Nenit 31 dhe 152 paragrafi 1 dhe Neni 45 paragrafi 1 i KPRK-së ndryshuar nga Neni 33 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe Neni 38, paragrafi 1 i KPRSFJ-së në formulimin e saj, siq ka hyrë në fuqi me 1 korrik 1977 që është mbajtur në fuqi nga Seksioni 1, paragrafi 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, ata janë dënuar si në vijim:

- **S.S. me 6 (gjashtë) vjet burgim;**
- **J.D. me 5 (pesë) vjet burgim;**
- **Z.D. me 5 (pesë) vjet burgim;**
- **I.T. me 5 (pesë) vjet burgim;**

III. Në bazë të Nenit 80, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1 i KPRK-së për të gjithë veprat penale që i atribuohen **J.D., Z.D., S.S., dhe I.T.**, dhe duke pasur parasysh dënimet individuale të dhëna për ato vepra penale ata janë dënuar me *dënime unike* si në vijim:

- **S.S. me 8 (tetë) vjet burgim;**
- **J.D. me 7 (shtatë) vjet burgim;**
- **Z.D. me 7 (shtatë) vjet burgim;**
- **I.T. me 7 (shtatë) vjet burgim;**

IV. Në bazë të Nenit 83, paragrafi 1 i KPRK-së periudha e privimit nga liria e **Z.D. dhe J.D.** nga data 23 maj 2013 dhe e **I.T.** nga data 24 maj 2013, përkatësisht, der me 31 maj 2013 gjersa në arrest shtëpiak, dhe nga data 31 maj 2013 gjer më 19 dhjetor 2014 gjersa në paraburgim, që llogaritur në fakt në dënimin unik me burgim që ishte caktuar ndaj secilit prej tyre;

V. Në bazë të nenit 453, paragrafi 3 i KPRK-së, kostoja e procedurës penale është urdhëruar që të re-imburohet pjesërisht nga:

- J.D., në shumën e caktuar prej 1000 euro;
- Z.D., në shumën e caktuar prej 500 euro ;
- S.S., në shumën e caktuar prej 500 euro;
- I.T., në shumën e caktuar prej 500 euro;
- A.D., në shumën e caktuar prej 300 euro;
- B.D., në shumën e caktuar prej 300 euro ;
- D.D., në shumën e caktuar prej of Euro 300;
- S.D., në shumën e caktuar prej 300 euro;
- F.D., në shumën e caktuar prej 300 euro ;
- N.D., në shumën e caktuar prej 300 euro;

ndërkohë që çdo shpenzim i mbetur i procedurës penale do të paguhet nga mjetet buxhetore.

C. Ankesat

Me 06 gusht 2015 Prokurori Special ka parashtruar ankesë ndaj Aktgjykimit.

Me 01 gusht 2015, avokati mbrojtës B.M. në emër të të pandehurit N.D. ka parashtruar një ankesë. Me 3 gusht 2015 avokati mbrojtës V.B. në emër të të pandehurit F.D. dhe avokati mbrojtës B.T. në emër të të pandehurit Z.D. kanë parashtruar ankesë ndaj aktgjykimit. Me 05 gusht 2015 avokati mbrojtës K.O. në emër të të pandehurit D.D., avokati mbrojtës R.M. në emër të të pandehurit S.D., avokati mbrojtës A.Q. në emër të të pandehurit I.T. dhe avokati mbrojtës M.S. në emër të të pandehurit J.D. kanë parashtruar ankesë ndaj aktgjykimit të kundërshtuar. Me 06 gusht 2015 avokati mbrojtës I.A. në emër të të pandehurit A.D. dhe avokati mbrojtës S.I. në emër të të pandehurit B.D. kanë parashtruar ankesë. Me 7 gusht 2015 Avokati Mbrojtës G.G.-S. në emër të të pandehurit S.S. kanë parashtruar ankesë kundër aktgjykimit.

Rasti u transferua në Gjykatën e Apelit për një vendim mbi ankesat me datë 23 shtator 2015.

Me 28 tetor 2015 Prokurori i Apelit ka parashtruar një mocion.

Seancat e Gjykatës së Apelit qenë mbajtur me datat 16, 17, 19 maj 2016.

Kolegji i Apelit diskutoi dhe votoi me datë 09 gusht dhe 14 shtator 2016.

III. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e Prokurorit të PSRK-së:

Prokurori Special me datë 06 gusht 2015 ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore.

Sipas ankesës së PSRK-së aktgjykimi i Gjykatës Themelore sfidohet për shkak të përcaktimit të gabuar të dënimit për t'u aplikuar.

Prokurori i PSRK-së kërkon që të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore duke e rritur në mënyrë adekuate dënimin kundër të gjithë të pandehurve.

Ai deklaron se të gjitha dënimet e dhëna janë në disproporcion me seriozitetin dhe natyrën e veprës penale.

Ai thekson se Gjykata Themelore ka aplikuar tre faktorë lehtësues për të caktuar një dënim më të butë brenda kufijve të përcaktuar nga gjykata ndaj të gjithë të pandehurve në vend të njohjes së ekzistimit të rrethanave rënduese dhe aplikimit të një dënimi më të rëndë ndaj të dhjetë të pandehurve.

B. Ankesa e avokatit mbrojtës A.Q. në emër të të pandehurit I.T.:

I pandehuri I.T. është gjetur fajtor për të dyja pikat e akuzës.

Avokati mbrojtës A.Q. me datë 05 gusht 2015 ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në emër të të pandehurit I.T..

Avokati mbrojtës A.Q. kërkon nga Gjykata e Apelit që ta mbajë një seancë në mënyrë që të bëjë pranimin e pjesëve të provave; për ta ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe për ta shpallur të pandehurin I.T. dhe të pandehurit e tjerë të pafajshëm apo për ta anuluar vendimin dhe për ta dërguar çështjen në rigjykim, para një trupi gjykues të ndryshëm të së njëjtës gjykatë të shkallës së parë.

Ai e sfidon përbërjen e Trupit Gjykues duke iu referuar Ligjit mbi Kompetencat e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Rregulloren e brendshme të EULEX-it mbi këtë çështje.

Ai e kundërshtoi shkeljen e Nenit 7 të KPPK-së dhe shkeljen e parimit të *in dubio pro reo*. Për më tepër, konkludoj se përfundimet e trupit gjykues nuk përshtaten me dispozitat e Nenit 262 të KPP-së Ai i kundërshton konkluzionet e trupit gjykues që bazohen vetëm në deklaratën e një dëshmitari.

Ai e kundërshton aktgjykimin për shkak të shkeljeve të dispozitave të KPP-së. Gjegjësisht ai kundërshton zbatimin e teorisë së "dëshmitarëve armiqësor", e cila nuk ka asnjë bazë në KPP. Ai mendon se trupi gjykues e ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe si pasojë e ka ndihmuar ndjekjen penale në mënyrë të papranueshme. Ai e ka kundërshtuar mënyrën se si i pandehuri I.T. është identifikuar nga Dëshmitari A meqë ishte në kundërshtim me Nenin 120 të KPP-së. Së fundi e ka kundërshtuar vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve ekspert Dr. B. dhe Dr. G. si shkelje të parimit *in dubio pro reo*.

Mbi bazat e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike paraqet kundërshtimet e tija në lidhje me vlerësimin e provave që do të thotë në mënyrë të detajuar analizon deklaratat dhe kredibilitetin e përgjithshëm të Dëshmitarit A. Ai thekson se versioni i tij është në kundërshtim me versionin e Dëshmitarit B. Ai i referohet aplikimit të tij për statusin e veteranit të UÇK-së dhe sëmundjes së tij mendore. Ai vë në dukje kontradiktën e deklaratës së Dëshmitarit A-së në krahasim me dëshmitarët Dr. H., Dr. B. dhe S.. Ai Arrin në përfundimin se vlera dëshmuese e Dëshmitarit A si një dëshmitar i rëndësishëm ishte mbivlerësuar në dëm të të pandehurit.

Ai e sfidon besueshmërinë e Dëshmitarit K i cili në mënyrë të çartë ka koordinuar me burrin e saj, Dëshmitarin A.

Në lidhje me dënimet ai kundërshton se gjykata nuk e ka konsideruar si të rëndësishme kohën e kaluar nga veprimet e pretenduara të të pandehurve dhe dënimi prej shtatë vitesh konsiderohet që të jetë i ekzagjeruar.

C. Ankesa e avokatit mbrojtës G.-S. në emër të të pandehurit S.S.:

I pandehuri S.S. është gjetur fajtor për të dyja pikat e akuzës.

Avokati mbrojtës G. G.-S. në emër të të pandehurit S.S. e ka parashtruar një ankesë me datë 7 gusht 2015.

Avokati mbrojtës G.-S. në ankesën e tij shpjegoi pikëpamjen e tij në lidhje me dështimet e procedurës së shkallës së parë dhe të aktgjykimit.

Avokati mbrojtës në ankesë thekson se aktgjykimi ka shkelur Nenin 7, paragrafin 1 të KPP-së dhe përmban deklarata të shumta të rrejshme dhe konkludime të cilat nuk janë mbështetur nga dosjet e provave.

Ai thekson se provat ishin të mjaftueshme për të identifikuar të pandehurin S. si kryes të krimeve të akuzuara dhe për të mbështetur aktgjykimin. Ai vë në dukje se çdo paqartësi ose dyshim që lind nga provat duhet të zgjidhet nga Trupi Gjykoes në favor të Z. S., në përputhje me parimin e *in dubio pro reo*. Nëse standardi "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*" nuk është përmbushur për çdo element të një krimi dhe çdo element të mënyrës së detyrimit të pretenduar për atë krim, i pandehuri S. kishte të drejtë për një aktgjykim të pafajësisë për këtë krim.

Ai gjithashtu vë në dukje se provat ishin të pamjaftueshme për të përcaktuar kryerjen e një krimi lufte si abuzim i zakonshëm që Dëshmitari A pretendonte të ketë përjetuar edhe nëse do ishte provuar, nuk ishte e lidhur ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë në atë kohë.

Avokati mbrojtës G.-S. përmend gjithashtu se refuzimi i Kryetarit të trupit gjykoes për të ua siguruar palëve procesverbalin verbatim të procedurave, përbën shkelje të ligjit. Ai kërkon anulimin e dënimit të Z. S. dhe hedhjen poshtë të akuzave.

Ai vë në dukje deklaratat kontradiktore dhe jo të besueshme të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B. Në vlerësimin e provave trupi gjykues i shkallës së parë në mënyrë të paligjshme dhe në mënyrë të përsëritur e ka zhvendosur barrën e provës tek të akuzuarit duke përfshirë edhe të pandehurin S.. Ai gjithashtu kundërshton vlerën dëshmisë të Dëshmitarit K. Për më tepër ai i kundërshton deklaratat paraprake të dëshmitarëve mbi një bazë të regjistrimit jo të saktë të deklaratave të tyre nga Prokurori i rastit.

Ai deklaron se dënimi i të pandehurit S. duhet që të hidhet poshtë ose në këtë rast ose në rastin Drenica 1 meqë ai është dënuar dy herë për të njëjtën vepër dhe se dënimi i dhënë është i ekzagjeruar.

Mbrojtësi gjithashtu thekson se kolegji i shkallës së parë ishte vetë i përbërë në mënyrë të paligjshme, trupi gjykues e ka shkelur detyrimin e tij për të përcaktuar dhe për të marrë parasysh të gjitha provat dhe për të siguruar për të pandehurin S. një gjykim të drejtë, kur dështoi për të përfshirë provat shfajësuese të Dëshmitarit L nga rasti Drenica 1 në provat e rastit të Drenica 2, përkatësisht dëshmia se Dëshmitari A ishte i sëmurë mendor dhe se i pandehuri S. është keq identifikuar nga ai si i pranishëm në Likoc.

Avokati mbrojtës thekson se trupi gjykues po ashtu është angazhuar edhe në gabime të tjera të shumta, si materiale dhe procedurale të cilat ia kanë mohuar të pandehurit S. një gjykim të drejtë dhe kanë rezultuar në një aktgjykim të pasigurt, dhe jo të besueshëm. Ai vazhdon se dënimet e të pandehurit S. duhet të anulohen dhe se të gjitha akuzat të hidhen poshtë.

D. Ankesa e avokatit mbrojtës B.T. në emër të të pandehurit Z.D.:

I pandehuri Z.D. është gjetur po ashtu fajtor për dy pika të akuzës.

Avokati mbrojtës B.T. ka parashtruar një ankesë në emër të të pandehurit Z.D. me datë 03 gusht 2015.

Avokati mbrojtës B.T. në ankesën e tij propozon që të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe të lirohet i pandehuri nga paraburgimi.

Në ankesën e tij mbrojtësi ofron një arsyetim të detajuar për argumentet e tija në veçanti në lidhje me dënimin e paqartë dhe veprimtarinë kriminale të papërcaktuar të të pandehurit Z.D.. Ai sfidon besueshmërinë e Dëshmitarit A për shkak të statusit mendor dhe dëshminë e tij brenda për brenda të papajtueshme dhe kontradiktore. Ai gjithashtu kundërshton mënyrën e dënimit, në mënyrë specifike e pa individualizuar dhe dënimet e rënda për të pandehurit.

E. Ankesa e avokatit mbrojtës M.S. në emër të të pandehurit J.D.:

I pandehuri J.D. është gjetur po ashtu fajtor për dy pika të akuzës.

Avokati mbrojtës M.S. ka parashtruar një ankesë në emër të të pandehurit J.D. me datë 05 gusht 2015.

Në ankesën e tij mbrojtësi propozon që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën, ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në mënyrë që i pandehuri J.D. të lirohet nga akuzat, ose të anulohet aktgjykimin dhe të ia kthejë lëndën Gjykatës Themelore për rigjykim dhe - në këtë rast - të ndërpresë paraburgimin ndaj të pandehurit J.D..

Ai ofron një arsyetim të detajuar për argumentet e tija, të tilla si përbërja e paligjshme e trupit gjykues të shkallës së parë, e përbërë nga tre gjyqtarë të EULEX-it në kundërshtim me ligjin;

dënimi i paqartë i të pandehurit J.D., meqë dispozitivi nuk e jep përshkrimin e saktë se cilat veprime ai i kishte ndërmarrë, për më tepër përshkrimi e tejkalon aktakuzën;

Aplikimi i dy kodeve të ndryshme penale dhe vendosja e papërshtatshme e dënimit të përgjithshëm për një vepër që duhet të karakterizohet si një vepër penale në vazhdim.;

disa shkelje të procedurës penale gjatë marrjes dhe vlerësimit të provave, duke përfshirë shkelje të Nenit 7 të KPPK-së ose aplikimin e teorisë së dëshmitarit armiqësor;

mbrojtja pretendon se në situatën e dhënë, Dëshmitarit A dhe Dëshmitari B nuk e kanë ngritur asnjë pretendim në lidhje me dëmet, është e qartë se ata nuk e konsiderojnë veten të dëmtuar, pra nuk kanë pësuar asnjë lëndim trupor;

vlerësimi joadekuat i deklaratave të Dëshmitarit A, duke vënë në dukje pretendimet e ngritura nga avokatët tjerë mbrojtës të përmendur më sipër.

Avokati mbrojtës M.S. gjithashtu vë në dukje se dënimi i shqiptuar kundër klientit të tij nuk është i arsyetuar në mënyrë të duhur.

F. Ankesa e avokatit mbrojtës, I.A. në emër të të pandehurit A.D. dhe Ankesa e avokatit mbrojtës S.I. në emër të të pandehurit B.D.:

Avokati mbrojtës I.A. në emër të të pandehurit A.D. dhe avokati mbrojtës S.I. në emër të të pandehurit B.D. kanë parashtruar Ankesa më datë 06 gusht 2015. Ankesat e tyre në fakt ishin identike.

Në ankesat e tyre avokatët mbrojtës pohojnë se gjendja faktike në aktgjykim është ndërtuar vetëm mbi deklaratën e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K dëshmitë e të cilëve ishin kontradiktore. Trupi Gjykues i ka injoruar provat shfajësuese, siç janë deklaratat e dëshmitarëve A.T., I.S. ose Dr. G.H..

Ata e kanë sfiduar besueshmërinë e Dëshmitarit A duke e theksuar sëmundjen e tij psikologjike, mospërputhjet në dëshminë e tij, deklaratat rreth lëndimeve të tija trupore të pësuar nga rrahjet në lidhje me vlerësimin mjekësor të tyre, kërkesën e tij për statusin e veteranit.

Në Ankesat e tyre avokatët mbrojtës argumentojnë se nëse është e mundur që të kryhen krime lufte kundër popullatës së vet.

G. Ankesa e avokatit mbrojtës K.O. në emër të të pandehurit D.D.:

Avokati mbrojtës K.O. ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit D.D. me datë 05 gusht 2015.

Në ankesën e tij mbrojtja vë në dukje kontradiktat e dispozitivit në krahasim me arsyetimin.

Ai e sfidon besueshmërinë dhe pranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit A, duke konkluduar se Dëshmitari A nuk ishte rrahur gjatë luftës, pasi ai nuk ka kërkuar ndonjë trajtim mjekësor gjatë asaj kohe. Për më tepër ai e përmend kontestin pronësor me familjen D. para luftës. Ai i referohet sëmundjes mendore të Dëshmitarit A dhe kontradiktat e dëshmisë së tij me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë.

Ai theksoi se D.D. nuk ishte i pranishëm në Kosovë në kohën kur kanë ndodhur krimet e pretenduara. Për më tepër nuk ka asnjë përkrahje të saktë të veprimeve të veçanta të marra nga i pandehuri.

Gjithashtu ai i apelon shkeljet ligjit penal, kualifikimin ligjor të aplikuar. Ai përfundon se nuk kishte elemente të veprës penale të përmbushura.

H. Ankesa e avokatit mbrojtës R.M. në emër të të pandehurit S.D.:

Avokati mbrojtës R.M. ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit S.D. me datë 05 gusht 2015.

Mbrojtja pohon se dëshmitarët anonim dhe deklaratat e tyre kontradiktore janë të papranueshme. Ai kundërshton besueshmërinë e Dëshmitarit A si dhe thekson se klienti i tij, i pandehuri S.D. nuk ishte anëtar i UÇK-së.

Mbrojtja deklaron se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë përmban kontradikta.

I. Ankesa e avokatit mbrojtës V.B. në emër të të pandehurit F.D.,

Avokati mbrojtës V.B. ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit F.D. me 3 gusht 2015.

Mbrojtja vë në dukje se deklarata e Dëshmitarit A ishte në kundërshtim dhe kontradiktore për të cilën arsye deklarata e tij është e papranueshme. Për më tepër aktgjykimi i shkallës së parë është kontradiktor përkatësisht në vlerësimin e lëndimit të të pandehurit F.D. dhe aftësinë e tij për ta përdorur dorën në kohën kur vepra penale ka ndodhur . Ai gjithashtu vë në dukje se i pandehuri nuk ishte i pranishëm në periudhën e dhënë në Likoc.

Mbrojtja deklaron se Gjykata Themelore e ka shkelur Nenin 262 të KPP-së, kur i ka vlerësuar provat si bazë të fajit.

J. Ankesa e avokatit mbrojtës B.M. në emër të të pandehurit N.D.:

Avokati mbrojtës B.M. ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit N.D. me datë 01 gusht 2015.

Avokati mbrojtës gjen kontradikta në deklaratat e Dëshmitarit A. Ai sfidon besueshmërinë e Dëshmitarit A në bazë të çrregullimit mendor të tij, aplikimin për statusin e veteranit të UÇK-së dhe mospërputhjeve të deklaratave të tija. Ai vë në dukje se gjykata themelore gabimisht i ka vlerësuar provat dhe arriti në një përfundim të papërshtatshëm për shkak të shkeljes së Nenit 262 të KPP-së. Për më tepër deklaratat e dëshmitarëve nuk janë mbështetur me ndonjë pjesë tjetër përkatëse të provave. Në të kundërtën, gjykata themelore injoroi dëshmitë e dëshmitarëve Dr. F.B. dhe Dr. B.G..

Mbrojtja vë në dukje kontradiktat në dispozitiv kur Gjykata Themelore e ka bërë vlerësimin e provave si baza të fajit[*sic*].

Të gjithë avokatët mbrojtës e konstatojnë të ekzagjeruar dënimin e shqiptuar në suazën e praktikës së Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë dhe në ankesat e tyre propozojnë që të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

K. Përgjigjet ndaj ankesave:

Prokurori i PSRK-së është përgjigjur të gjitha dhjetë ankesat e të pandehurve. Në përgjigjet e tij ai propozon për të hedhur poshtë të gjitha ankesat kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.

Përgjigjet e mbrojtësve janë të përsëritura dhe shprehin në vijim:

Ankesa e prokurorisë, duke pretenduar se faktorë të ndryshëm rëndues ekzistojnë ose që duhet të ishin konsideruar nga Trupi Gjykses nuk është i bazuar në një analizë të saktë të fakteve të këtij rasti apo ligjit dhe duhet të refuzohet në tërësi.

Të pandehurit në përgjigjet e tyre kërkojnë nga gjykata e apelit të refuzojë ankesën e prokurorit të PSRK-së si të pabazuar.

L. Mocioni i Prokurorit të Apelit:

Prokurori Apelit i Kosovës në Mocionin e tij kërkon nga Gjykata e Apelit:

Që ta aprovojë ankesën e S.S. pjesërisht dhe

- Korrigjojë aktgjykimin e kundërshtuar për të ia llogaritur atij periudhën që ai e kaloi në paraburgim para se të lëshohet aktgjykimi në rastin në fjalë;
- Për ta korrigjuar aktgjykimin e kundërshtuar përderisa e konsideron “ poshtërim” duke i detyruar viktimat që “ të heqin dorë nga dinjiteti njerëzor” si një faktor rëndësues përpos për ta konsideruar në vlerësimin e seriozitetit të krimit[*sic*].
- Për të hedhur poshtë pjesën e mbetur të ankesave të mbrojtjes;
- Për ta aprovuar ankesën e Prokurorit të PSRK-së dhe për të dhënë dënime më të rënda për të gjithë të pandehurit.

Prokurori i Apelit në mocionin e tij ofron një analizë të plotë të ankesave para se ai ta sqarojë mendimin e tij.

Prokurori i Apelit pajtohet me shumicën dërrmuese të parashtresave të Prokurorit të PSRK-së në lidhje me ankesat e të pandehurve.

Prokurori i Apelit vëren karakterin unik të çështjes në fjalë aq sa rezultati i saj në masë të madhe varet nga vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari - Dëshmitarit A.

Ai arriti në përfundimin se vendimi i Trupit Gjykyes që t'i besojë dëshmisë së tij është i arsyetuar mirë dhe të gjitha matricat e ndërlikuara të faktorëve të marrë në konsideratë mund të gjenden në aktgjykimin kundërshtuar.

Prokurori i Apelit gjithashtu vë në dukje se mbrojtja e kishte një mundësi që ta ballafaqojë Dëshmitarin A dhe në fakt veprimi në këtë mënyrë. Identiteti i tij ishte i njohur për të akuzuarit dhe në asnjë fazë të procedurave Dëshmitari A nuk ishte shpallur si dëshmitar bashkëpunues.

Prokurori i Apelit thekson se si pasojë, nuk kishte asgjë të gabuar në thelb duke u mbështetur në dëshminë e dhënë nga dëshmitari A për të ju hyrë dënimeve në rastin konkret.

Në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me barrën e provës, Prokurori i Apelit vëren se argumenti i mbrojtjes është i natyrës thjesht semantike. Nuk ka asgjë për të besuar se barra e provës ishte në fakt e zhvendosur në mbrojtje. Asnjë nga provat në të cilat është mbështetur mbrojtja nuk ka ngritur një dyshim të arsyeshëm në lidhje me këtë përfundim.

Në çështjen e teorisë së *dëshmitarit armiqësor* si është aplikuar nga Trupi Gjykues, Prokurori i Apelit thekson rëndësinë e mundësisë për të e ballafaquar dëshmitarin nga pala që e solli atë në gjendjen që dëshmitari e ndryshon deklaratën e tij në mënyrë të konsiderueshme.

Ajo mund të përmblihet shkurtimisht se Prokurori i Apelit pajtohet me konkluzionet e Trupit Gjykues. Në lidhje me pretendimet procedurale të mbrojtjes ai nuk vëren asnjë shkelje të rëndë që e diskualifikon aktgjykimin në tërësi. Prokurori i Apelit prandaj i drejtohet Gjykatës së Apelit për të vepruar si përshkruhet më sipër.

IV. GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT

A. Kompetenca e Panelit

Në bazë të Nenit 472(1) KPP-së Paneli e ka shqyrtuar kompetencën e vet. Në pajtim me Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe prokurorëve në Kosovë – Ligji nr 03/L-053 siq është ndryshuar nga Ligji nr. 04/L-273 dhe sqaruar me anë të Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 18 qershor 2014, Paneli konstaton se EULEX-i ka juridiksion mbi rastin dhe se Paneli është kompetent për të vendosur mbi çështjen përkatëse në përbërjen e dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës.

B. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i kundërshtuar qe shpallur me datë 27 maj 2015. Të gjitha ankesat janë paraqitur brenda afatit 15-ditor në pajtim me Nenin 380 (1) të KPP-së. Ankesat janë parashtruar nga personat e autorizuar dhe i përmbajnë të gjitha informacionet në përputhje me Nenin 376 et seq të KPP-së. Dhe prandaj, ato janë të pranueshme.

C. Gjetjet mbi meritat

Kolegji i Ankesave së pari do të shqyrtojë çështjet procedurale ligjore të Aktgjykimit. Së dyti, Paneli do të kthehet për të diskutuar sfidat e ngritura në ankesa në lidhje me çështjet thelbësore dhe ligjore të aktgjykimit.

1. Ligji procedural në fuqi

Aktakuza qe parashtruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me datë 8 nëntor 2013. Në këtë kohë, Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123 (KPP) ka qenë në fuqi. Në bazë të nenit të saj 540.

për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi në të cilën nuk është ngritur aktakuzë, dispozitat e këtij kodi do të zbatohen mutatis mutandis.

Hetimi është iniciuar me datë 19.01.2012, para se KPP ka hyrë në fuqi; aktakuza qe ngritur me datë 8 nëntor 2013, kur KPP ishte në fuqi, kështu që dispozita e cituar më sipër duhet të zbatohet.

2. Përbërja e trupit gjykues

Çështja më e rëndësishme procedurale e ngritur në ankesa përbehej nga kundërshtimet kundër përbërjes së trupit gjykues. Kundërshtimet janë bazuar mbi baza të ndryshme. Paneli është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e kësaj çështjeje si garanci themelore e një gjykimi të drejtë. Për këtë arsye do të i kushtohet një vëmendje e kujdesshme kësaj çështjeje.

Caktimi i tre gjyqtarëve të EULEX-it në panel u kundërshtua në lidhje me të referuarit në Ligjin No. 03/L-053. Trupi Gjykues e ka shpjeguar situatën në mënyrë të detajuar në pikat 12 dhe 13 të aktgjykimit të kundërshtuar. Kolegji i Apelit plotësisht pajtohet me këtë arsyetim dhe nuk e sheh nevojën për të shtuar komente.

Një tjetër kundërshtim është bazuar në faktin se një nga anëtarët e trupit gjykues nuk gjykonte në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Duke iu referuar ligjit dhe Rregullores së EULEX-it, gjyqtari që gjykon në Gjykatën Themelore të Prishtinës mund të ketë qenë i caktuar për rastin në Gjykatën Themelore të Mitrovicës vetëm si gjyqtar zëvendësues. Paneli vlerëson se kjo çështje nuk është përmendur asnjëherë më herët para se me u paraqitur ankesat. Caktimi i gjyqtarëve në gjykata nuk është fshehtësi, siç është edhe baza ligjore për caktimin e tyre në raste. Kundërshtimi nuk është ngritur asnjëherë gjatë procedurës së shkallës së parë, ndonëse nuk kanë pasur pengesa për të vepruar kësisoj. Sipas Nenit 382 paragrafit 6 të KPP, prandaj është i vonuar.

Kundërshtimet në vijim janë ngritur me caktimin e një anëtari të trupit gjykues duke e anashkaluar pozitën e orarit të gjyqtarëve të EULEX-it brenda sistemit për caktimin e gjyqtarëve. Sipas të gjitha gjasave është kërkuar nga kryetar i trupit gjykues në mënyrë që me përkrahur karrierën profesionale të kolegut të tyre.

Paneli i shqyrton pohimet të cilat janë ngritur pas publikimit të një lajmi të tillë në media pasi që është shpallur aktgjykimi. Kjo pikë e ankesës nuk mund të konsiderohet si e vonuar, pasi që bazat nuk kanë qenë të njohura për palët gjatë procedurës para gjykatës së instancës së parë. Trupi gjykues megjithatë përfundon se këto kundërshtime janë të pabaza.

Në kontrast me akuzat, asnjë orar për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it nuk është mbajtur në vitin 2013. Po ashtu, caktimi i anëtarëve të trupit gjykues në lëndën në fjalë, është kryer në mënyrë zyrtare nga Kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it, i cili është autorizuar për një vendim të

tillë. Ankimuesit e kane theksuar bisedën telefonike në mes të kryetarit të trupit gjykues dhe kryesi i detyrës së gjyqtarëve të EULEX-it, disa minuta para se të nënshkruhej vendimi mbi caktimin. Përmbajtja e një telefonate të tillë nuk është dhe nuk mund të njohët, kështu që konkluzioni i qartë se është nevojitur një gjyqtar i caktuar—si anëtar i trupit gjykues- nuk mund të arrihet. Shkëmbimi me poste elektronike siç është paraqitur në ankesa, as nuk e përfshin një kërkesë tillë. Si pasojë e kësaj, nuk ka prova për të përfunduar se caktimi i panelit i ka shkelur rregullat dhe ka mundur të ndikojë në paanshmërinë e trupit gjykues. Përveç kësaj, trupi gjykues nuk vëren ndonjë parregullsi në punën e trupit gjykues të paraqitur në procesverbalin e seancave të gjykimit.

3. Dëshmitarët në një lokacion në largësi

Ankimuesit e kundërshtojnë dhënien e dëshmisë nga ana e dëshmitarëve, prej një vendi në distancë përmes video linkut gjatë procedurës së instancës së parë.

Paneli i ankesave është i mendimit se pajisjet për video-konferencë me audio komunikim të dyanshëm në kohë reale ka punuar në mënyrë të duhur dhe ka funksionuar mirë gjatë procedurës së instancës së parë. Të gjitha çështjet teknike janë zgjedhur në mënyrë të duhur gjatë procedurës së instancës së parë. Fakti se dëshmitari i cili ka dëshmuar, ka qenë në një vend në largësi nuk ka pasur fare ndikim në procedurë. Nuk ka pasur ankesa kundër funksionalitetit të sistemit gjatës shqyrtimit gjyqësor.

4. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor

Ka pasur edhe një pohim që e ka sfiduar mënyrën se si është regjistruar shqyrtimi gjyqësor. Mbrojtja thekson se kryetari i trupit gjykues të instancës së parë ka refuzuar me i siguruar palëve një procesverbal me shkrim të procedurës. *Është theksuar se sipas nenit 315 para. 1 dhe 2 të KPPK procesverbalit i shqyrtimit gjyqësor duhet të përpilohet me shkrim. Në procesverbal duhet të shënohet thelbi i rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor. Përveç kësaj, shqyrtimi gjyqësor regjistrohet në mënyrën audio ose video ose në mënyrë stenografike, përveç nëse ka shkaqe të arsyeshme për të mos bërë një gjë të tillë.*

Paneli vlerëson se në bazë të nenit 315 paragrafit 5 të KPPK parashihet që për mënyrën e regjistrimit të shqyrtimi gjyqësor vendos gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.

Sipas nenit 316 paragrafit 1 të KPPK kur shqyrtimi gjyqësor regjistrohet vetëm me shkrim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me propozim të palës ose sipas detyrës zyrtare, mund të urdhërojë që deklaratimet që i konsideron të një rëndësie të veçantë të përfshihen tekstualisht në procesverbal.

Pas shqyrtimit të dispozitave të lartshënuara, paneli është i mendimit se kryetari i trupit gjykues të instancës së parë e ka marrë një vendim të duhur se si do të duhej të regjistrohet shqyrtimi gjyqësor. Rezultati është tekstualisht-fjalë për fjalë-procesverbal i shqyrtimit gjyqësor. Mungesa e një audio ose video incizimi është arsyetuar me mbrojtjen e dëshmitarëve. Paneli e vlerëson një arsyetim të tillë në pajtim me ligjin.

Përdorimi i procesmbajtësve të cilët i shtypin procesverbalet drejt për drejt në formatin e Microsoft Word në vend se me marrë shënime me shkrim përdoret gjerësisht dhe është një metodë e pranuar për seancat dëgjimore në Gjyqësorin e Kosovës. Monitori refleks para kryetarit të trupit gjykues i ka dhënë atij mundësinë adekuate për të përcjelle dhe korrigjuar procesverbalin gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si pasojë e kësaj, ai nuk e ka përpiluar atë por ka mundur me garantuar se deklaratat janë regjistruar ashtu siç janë paraqitur. Përveç kësaj, të gjitha palët kanë mundur me kërkuar që procesverbali me u lexuar aty për aty dhe gjithashtu kanë mundur me i paraqitë vërejtjet e tyre kundër përmbajtjes së procesverbalit (neni. 316 par. 2). Kryetari i trupit gjykues gjatë gjykimit të instancës së parë është ballafaquar me të gjitha kundërshtimet në kohë dhe i ka zgjidhur çështjet e ngritura.

Prandaj paneli e gjen si të pabazë ankesën se mënyra se si është regjistruar shqyrtimi gjyqësor nuk është mënyra e duhur. Duhet të theksohet se kundërshtimet në lidhje me procesverbalin, të ngritura në ankesë, ishin të përgjithshme, nuk kanë theksuar ndonjë pjesë të caktuar të deklaratës, të regjistruar në mënyrë të gabuar.

5. Koncepti i dëshmitarit armiqësor

Mbrojtja e kanë kundërshtuar përdorimin e konceptit të dëshmitarit armiqësor për marrjen në pyetje të një dëshmitari, një koncepti si i tillë nuk është i paraparë në KPPK. Këto kundërshtime janë refuzuar nga trupi gjykues i instancës së parë gjatë procedurave. Avokatët mbrojtës i kanë përsëritur kundërshtimet e tyre në ankesat e paraqitura.

Trupi gjykues i ka lejuar prokurorit me e shpallur Dëshmitarin B, të propozuar nga prokuroria si armiqësor. Si pasojë e kësaj, Prokurorit i është dhënë e drejta me e marrë në pyetje dëshmitarin pa asnjë kufizim, të cilat zakonisht zbatohen gjatë marrjes në pyetje të drejt për drejt sa i përket parashtrimit të pyetjeve drejtuese dhe në lidhje me përdorimin e deklaratave të procedurë paraprake. Palët janë udhëzuar që deklaratat e dëshmitarëve në procedurën paraprake nuk do të përdoren mëgjithatë si prova direkte.

Ekziston një shpjegim shterues i konceptit të dëshmitarit armiqësor, siç është aplikuar nga trupi gjykues, në aktgjykimin e kundërshtuar në pikën 43.

Trupi gjykues duhet të pranon se koncepti i dëshmitarit armiqësor është i panjohur dhe i parregulluar sipas KPPK-së. Megjithatë, neni 9 i KPPK e parasheh barazinë e palëve si njëri prej parimeve të procedurës penale. Kjo dispozitë ligjore, i referohet qartë sistemit ligjor të kundërt. Neni 7 paragrafi 1 e parasheh obligimin e përgjithshëm për të vërtetuar tërësisht dhe saktësisht, faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm.

Rregullat ligjore për marrjen në pyetje të dëshmitarëve janë përmendur në Nenet 332 – 335 të KPPK. Asnjëra prej këtyre dispozitave nuk e adreson ndërrimin e tërësishëm të dëshmisë të dëshmitarit. Paneli këtë e konsideron si një zbrastirë në ligj. Mungesa e një reagimi të ligjshëm të një qarkullimi parimor të një deklaratë të dëshmitarit është në kundërshtim të drejt për drejt me të drejtën e përgjithshme të procedurave penale, siç janë paraparë në nenin 7 të KPPK.

Aplikimi i konceptit të dëshmitarit armiqësor është një mjet për të siguruar se si është i rëndësishëm përcaktimi i fakteve për marrjen e një vendimi të ligjshëm, edhe për shkak se në kontrast me sistemet e tjera nuk është e mundur në Kosovë për palën që e sponsorizon një dëshmi të tërhiqet nga marrja në pyetje e dëshmitarit kur ai veq është propozuar. Duke i krahasuar nenet në teori të cilat janë me origjinë nga shtetet ku sistemi i kundërshtues është në fuqi¹ dhe jurisprudencës së Tribunalit të Hagës për krime lufte në ish Jugosllavi² paneli vlerëson se koncepti i dëshmitarit armiqësor është një pjesë integrale e procedurave kundërshtuese. Si pasojë e kësaj, paneli pajtohet me aplikimin e gjykatave të instancës së parë të këtij koncepti dhe i konfirmon bazat ligjore për përdorimin e tij, siç janë elaboruar në pikën 43 të aktgjykimi të kundërshtuar.

6. Hetimet gjatë procedurës paraprake

Mbrojtja e sfidon pranueshmërinë dhe vlerën e provave të deklaratave të dëshmitarëve gjatë procedurës paraprake, duke iu referuar metodës së marrjes në pyetje të Prokurorit Maurizio Salustro, i cili i ka mbajtur seancat e intervistave të procedurës paraprake në lëndën në fjalë. I thekson deklaratat e dëshmitarëve të shumë të cilët e përshkruajnë regjistrimin e pasaktë të dëshmisë së tyre në fazën e procedurës paraprake. Ky kundërshtim është përkrahë nga regjistrimi i dëshmimeve të procedurës paraprake të marra nga prokurori Salustro në një rast tjetër, ku është regjistruar tekstualisht vetëm një pjesë e intervistës, ndërsa pjesa tjetër e bisedës në mes të prokurorit Salustro dhe dëshmitarit ka qenë jashtë regjistrimit. Duke i pasur rrethanat e intervistave të procedurës paraprake, mbrojtja e konteston pranueshmërinë në përgjithësi të deklaratave të procedurës paraprake.

Sipas nenit 123 paragrafit 1, 2 të KPK aktual *gjatë fazës së hetimit mund të merren prova nga dëshmitarët dhe ekspertët në njëri nga këto tri mënyra: marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake ose mundësia hetuese e veçantë.*

Marrja në pyetje në procedurë paraprake zbatohet nga prokurori i shtetit. Procesverbali i kësaj marrje në pyetje vendoset në shkresat e lëndës. Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, vendimet për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor,

¹ <http://www.alrc.gov.au/publications/5.%20Examination%20and%20Cross-Examination%20of%20Witnesses%20/cross-examination-witnesses>

<http://www.duhaime.org/LegalDictionary/H/HostileWitness.aspx>

2

<https://books.google.com/books?id=JaLISni6OQwC&pg=PA897&lpg=PA897&dq=concept+of+hostile+witness+and+ECHR&source=bl&ots=rq4ntell0h&sig=RDHGTka6izLDyaEpqHFN1aYqj14&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwj1aDhz7bNAhWJJoKHbXLA6oQ6AEIQzAF#v=onepage&q=concept%20of%20hostile%20witness%20and%20ECHR&f=false>

por mund të përdoret gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmitarëve nëse dëshmitari ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake.

Dhënia e dëshmisë gjatë procedurës paraprake do të zhvillohet nga prokurori shtetëror në pajtim me nenet 132-133 të këtij Kodi [...].

Sipas nenit 131 (*Intervista e procedurës paraprake*) Paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 i KPPK

1. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit mund të thërret dëshmitarët, viktimat, dëshmitarët bashkëpunues, dëshmitarët e mbrojtur dhe ekspertët që të japin informata në marrjen në pyetje në procedurën paraprake që është relevante për procedurën penale.

2. Prokurori i shtetit mund të lejojë mbrojtësin, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të merr pjesë në marrjen në pyetje në procedurë paraprake.

3. Gjatë marrjes në pyetje, prokurori i shtetit mund të pyesë personin i cili merret në pyetje lidhur me provat materiale. Provat materiale duhet të identifikohen qartë në procesverbalin, transkriptin ose raportin mbi marrjen në pyetje.

4. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të incizohet audio, të incizohet audio dhe video, të transkriptohet fjalë për fjalë ose të përmbledhet në një raport. Incizimi, transkripti apo raporti janë në pajtim me Kapitullin XI dhe i bashkëngjiten shkresave të lëndës.

5. Personi i cili merret në pyetje nga ky nen mund të dëshmojë më vonë gjatë marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ose në mundësinë hetuese të veçantë.

Sipas nenit 132 paragrafi 6 i KPPK *Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklaratata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.*

Duke marrë parasysh dispozitat e KPPK siç janë cituar më lartë, paneli arrin deri tek konkluzioni, marrja në pyetje e dëshmitarit në fazën e procedurës paraprake të rastit në fjalë është kryer si një intervistë në procedurën paraprake pasi që as avokati mbrojtës e as i pandehuri nuk janë informuar. E njëjta formë është përdorë në rastin e paraqitur nga avokati mbrojtës në ankesë. Neni 131 paragrafi 4 i KPPK lejon përmbledhjen e deklaratave të procedurës paraprake në një raport. Prandaj raporti përmbledhës i paraqitur nga ankuesi nuk dëshmon se është shkelur ndonjë ligj procedural, në fakt nuk i përjashton deklaratat e procedurës paraprake të dëshmitarit në rastin në fjalë. Megjithatë, përdorimi i intervistës së procedurës paraprake si provë është rreptësishtë i udhëhequr nga neni 123 paragrafi 2 i KPPK. Paneli vlerëson se trupi gjykues në vlerësimin e provave nuk i ka tejkualuar kufijtë e paraparë në nenin 123 të KPPK.

7. Neni 262 i KPPK

Ankimuesit kanë theksuar, dhe paneli pajtohet, që dënimi i të pandehurve është i bazuar kryesisht në deklaratat e dëshmitarit të vetëm, kryesisht të Dëshmitarit A. Duke iu referuar nenit 262 të KPPK, ankimuesit pajtohen se në një situatë të tillë, vendimi që e shpall fajtor e shkel ligjin.

Neni 262 i KPPK parasheh si në vijim:

Provat për përcaktimin e fajësisë

1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

2 Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.

3. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.

4. Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Paneli vlerëson se asnjëra prej rrethanave të adresuara në dispozitat e lartshënuara nuk janë paraqitur. Dëshmia e dëshmitarit A është dhënë para gjykatës gjatë dëgjimit dhe para të pandehurve, si dhe avokatët mbrojtës kanë pasur mundësi të plotë për të siguruar marrjen në pyetje të tij. Të pandehurit kanë qëndruar të qetë, kështu që asnjë prej konkluzioneve nuk janë bazuar në deklaratat e tyre. Identiteti i Dëshmitarit A ka qenë i njohur për të pandehurit dhe avokatët mbrojtës dhe ai nuk është shpallë si dëshmitar bashkëpunues.

Paneli megjithatë mendon se nëse dëshmitari i vetëm jep prova vendimmarrëse, kërkesat për besueshmërinë e tij në përgjithësi – dhe në veçanti në lidhje me dëshminë e tij-janë më të larta dhe duhet të shqyrtohen thellësisht.

8. Kredibiliteti i Dëshmitarit A

Trupi gjykues e ka dëgjuar dëshmitarin A në seanca të shumta, duke përfshirë marrjen në pyetje tërthorazi nga mbrojtja. Pas vlerësimit përfundimtar të dëshmisë së tij ai është vlerësuar si kredibil dhe plotësisht i besueshëm. (që nga pika 95 e aktgjykimit të kundërshtuar).

Paneli pajtohet plotësisht me vlerësimin e tillë.

Paneli është i vetëdijshëm se procedura penale në Kosovë bazohet në parimin se i takon gjykatës që të bëjë dëgjimin, vlerësimin dhe të peshojë provat në gjykim. Prandaj, gjykata e apelit kërkohet

që t'i nënshtrohet vlerësimit të kredibilitetit të dëshmitarit nga trupi gjykues, përveçse nëse provat e bazuara në trupin gjykues nuk kanë mundur të pranohen (p.sh. në rast të kontradiktave të brendshme apo logjike...) nga ndonjë gjykatë e arsyeshme, apo nëse vlerësimi i tyre ka qenë plotësisht i gabueshëm.

Fillimisht paneli e ka shqyrtuar besueshmërinë e përgjithshme të Dëshmitarit A, besueshmërinë e tij personale. Ka pasur disa kundërshtime të ngritura në ankesa. Trupi gjykues është marrë me ato në arsyetim, megjithatë Paneli i Ankesave e konsideron si të nevojshme me i dhënë observimet e tij.

Tri rrethana parimore janë theksuar në ankesa në mënyrë që me e diskualifikuar besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit A. Kryesisht ka qenë diagnoza e tij P.A., aplikimi i tij për veteran të UÇK-së dhe mosmarrëveshjet e tij fqinjësore me disa prej të pandehurve që nga koha para luftës.

Sa i përket diagnozës së P.A., është përcaktuar në vitin 2003, se nuk ka pasur ndonjë dosje apo recidivizëm. Dëshmitari Dr. G.H., i cili është certifikuar me një diagnozë të tillë, ka theksuar se ai nuk e ka kujtuar ekzaminimin mjekësor të Dëshmitarit A. Ai nuk ka mundur me i individualizuar simptomat specifike nga të cilat ka vuajtur Dëshmitari A. Prandaj përshkrimi i tij ka qenë thjesht i përgjithshëm. Paneli plotësisht pajtohet me vlerësimin e tij se nuk është përfundimtar. Përkundrazi, e vetmja provë mjekësore e një sëmundjeje të tillë daton nga viti 2003, pas asnjë trajtim pasues, mjekim apo vëzhgim. Diagnoza ka qenë e natyrës akute e jo kronike, gjë që korrespondon me mungesën e ndonjë recidivizmi. Përkundër përsëritjes të marrjes në pyetje dhe shterues të Dëshmitarit A para gjykatës, nuk janë vërejtur simptomat e ndonjë sëmundjeje mentale. Paneli është i mendimit se paraqitja unike e P.A. nuk e ul besueshmërinë e përgjithshme të Dëshmitarit A.

I njëjti konkluzion është adoptuar në lidhje me aplikimin për statusin e veteranit të UÇK-së. Është një fakt i njohur që statusi i veteranit të UÇK-së i sjell mbajtësit të tij përfitim material. Ekzistojnë kushte të ndryshme në bazë të cilave aprovohet një status i tillë. Nuk ka të bëjë vetëm me pjesëmarrje e drejt për drejt në luftë por gjithashtu edhe çfarëdo përkrahje e luftëtareve. Aplikimi i dëshmitarit A nuk është bazuar në pjesëmarrjen e veprimeve ushtarake por më shumë në përkrahjen e luftëtarëve³, të cilët janë paraqitur në fshatin e tij. Asnjë prej aktiviteteve të tij të përshkuara në aplikacionin e tij, duke përfshirë mirëmbajtjen e armëve, nuk e demonstrojnë përfshirjen e tij në luftë direkt. Në anën tjetër, përkrahja e tij ndaj anëtarëve të UÇK-së në fshatin e tij është autentike. Aplikimi i tij nuk e tregon tentimin e tij për të marrë fitim material të pamërituar, më shumë si një përpjekje e tij për të për përmirësuar gjendjen e tij financiare në bazë të ndihmës së padiskutuar që i ka ofruar UÇK-së në kohën e luftës.

Sa i përket mosmarrëveshjeve fqinjësore, nuk janë marrë prova në këtë drejtim dhe nuk është propozuar asnjë provë nga ndonjëra prej palëve. Kjo çështje është ngritur vetëm në fazën e

³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 12 gusht 2014 faqe 11

procedurës së ankesave pas ndonjë shpjegim të mëtejshëm. Si pasojë e kësaj, një ankesë e tillë kundërshtuese nuk mund të konsiderohet si relevante.

Duke u bazuar në konkluzionet e lartpërmendura, paneli e ndan plotësisht vlerësimin e trupit gjykues të dëshmitarit A si dëshmitar i besueshëm.

Një vëmendje e veçantë i është dhënë besueshmërisë së deklaratës specifike të Dëshmitarit A në lidhje me secili prej të pandehurve.

Duhet të theksohet se marrja në pyetje e dëshmitarit është bërë pas kalimit të një kohe të rëndësishme prej kohës kur janë përjetuar këto ngjarje jashtëzakonisht traumatike dhe mjaft të gjata. Kjo është qartë e kuptueshme se shumë detaje dhe veçantitë mund të jenë të paqarta, t/ kujtuara pa ndonjë saktësi dhe riprodhimi i tyre mund të vuan nga deficitet e mbajtjes. {Paneli është i mendimit se të gjitha kundërshtimet e ashtuquajtura të theksuara në listën e provave të paraqitur si plotësim i ankesës, si dhe mospërputhjet në lidhje me hollësitë, siç janë uniformat e apo rrobat civile të veshura nga kryesit dhe veçantitë tjera më të vogla të kësaj natyre.

Përshkrimi i përgjithshëm i ngjarjeve të cilat kanë ndodhur gjatë kapjes së tij, janë konsistente përkundër pyetjeve të përsëritura në lidhje me hollësitë e shumta, të parashtruara gjatë tërë procedurës. Dëshmitari A disa herë para gjykatës ka përsëritur të gjithë emrat e kryesve/pandehurve⁴, dhe ka konfirmuar se të gjithë ata kanë marrë pjesë në rrahjen e tij. Ai i kishte njohur të gjithë kryesit personalisht, kështu që ai ka mundur me i identifikuar secilin prej tyre pa asnjë dyshim. Deklaratat mbi alibinë, të dhëna nga disa prej të pandehurve nuk mund të konsiderohen relevante.

As të pandehurit e as dëshmitarët, të cilët i kanë përkrahur ato deklaratat, nuk kanë dhënë përcaktimin specifik të kohës së cilës ata i referohen. Datat e sakta të kapjes së Dëshmitarit A janë të paqarta. Deklaratat e përgjithshme të cilat e aprovojnë prezencën e disa prej të pandehurve jashtë Kosovës gjatë verës 1998 nuk e përjashtojnë prezencën e të pandehurve në Likoc, siç është përshkruar nga dëshmia e besueshme e Dëshmitarit A. Prandaj paneli plotësisht pajtohet me konkluzionet e gjykatës së instancës së parë sa i përket dëshmitarëve B.V. dhe D.R. (pika 159 i aktgjykimit të kundërshtuar), I.X. (pika 167) dhe S.M. (pika 172). Gjithashtu vlerësimi i trupit gjykues i dhënë nga dëshmitari Dr. F.B. dhe Dr. B.G. është logjik dhe i arsyeshëm. Sa i përket deklaratës së dëshmitarit R.S., paneli i ndan plotësisht dyshimet e trupit gjykues në lidhje me besueshmërinë e tij dhe si pasojë e kësaj qëndron pas vlerësimit të dëshmisë së tij siç është paraqitur në pikat 153-157 të aktgjykimit të kundërshtuar.

Paneli pajtohet plotësisht me konkluzionin e paraqitur në aktgjykimin e kundërshtuar se deklaratat e Dëshmitarit A është përkrahur nga ato të Dëshmitarit K dhe dëshmitarit ekspert C.B..

9. Vërtetimi i dëshmisë së Dëshmitarit A

⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 15 shtator 2014 faqe 10 në lidhje me akuzën I

Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 11 gusht 2014, faqe 18, 12 gusht 2014 faqe 14 në lidhje me akuzën II

Dëshmitari K ka qenë në gjendje me siguruar prova konsistente në lidhje me kapjen e burrit të saj, Dëshmitarit A, kushtet e qendrës së paraburgimi në Likoc dhe gjendja personale fizike e Dëshmitarit A pas lirimit të tij. Dëshmitari K ka thënë se burri i saj ka pasur gjendje të mirë fizike kur është kapur nga ushtarët e UÇK-së dhe se ai ka qenë në gjendje shumë të rëndë fizike kur është liruar. Në deklaratën e saj ajo nuk ka përsëritur hollësitë e deklaratës së dëshmitarit A, po më shumë ka përshkruar se si e ka përjetuar ajo vet. Dëshmia e saj e vërteton kohën dhe kohëzgjatjen e kapjes së burrit të saj dhe gjendjen e tij fizike dhe psikike pas lirimit të tij. Dëshmitari K është mundura me e vizituar Dëshmitarin A në qendër të paraburgimit në Likoc. Ajo prandaj ka dëshmuar ekzistimin e qendrës së paraburgimit aty. Asaj nuk i është lejuar që të viziton burrin e saj, Dëshmitarin A, në qendrën e paraburgimit, gjë që dëshmon faktin se Dëshmitari A nuk ka qëndruar aty vullnetarisht dhe gjithashtu e konfirmon privimin e të paraburgosurit për të kontaktuar familjen e tij.

Eksperti dëshmitar C.B. ka ekzaminuar kushtet shëndetësore të Dëshmitarit A. Duhet të vlerësohet se ky ekzaminim është bërë para 15 viteve pasi që janë pësuar lëndimet e dyshuara. Ajo qartë e ka theksuar se pasi që ka kaluar një kohë aq e gjatë, ekzaminimi nuk mund të përcakton kohën e saktë se kur janë pësuar lëndimet, e as mekanizmi i tyre. Megjithatë, ajo i ka vërejtur brinjët e thyera dhe eshtrat tjera, si dhe vragën në zonën e qeseve të herdheve.

Paneli pajtohet me vlerësimin e dëshmisë së saj, siç është paraqitur në pikën 115 dhe 116 të aktgjykimit të kundërshtuar. Sa i përket pikës 114 të aktgjykimit të kundërshtuar paneli vëren se lëndimet tjera të dëshmitarit A nuk mundem medoemos me iu atribuuar rrahjeve specifike në Likoc, por ato janë rezultat i rrahjeve të pësuar në Likoc, por ato janë si rezultat i rrahjeve të pësuar gjatë mbajtjes së dëshmitarit A në atë vend.

Përshkrimi i dëshmitarit A “plagë e hapur” në qesen e herdheve, është kundërshtuar nga ankuesit, është më e kuptueshme në kontekst të përshkrimit të përgjithshëm të lëndimeve me vragë të dukshme si të “hapura”, siç është përdorë vazhdimisht në deklaratën e Dëshmitarit A.⁵

S ai përket mënyrës se si është dhënë dëshmia –nga Dr. G. – është kryer nga gjykata e instancës së parë, Paneli vëren se Dr. G. ka qenë i përfshirë në mënyrë që me e kryer ekzaminimin e pjesëve intime të dëshmitarit nga një person të të njëjtës gjini. Dr. G. pas ekzaminimit i ka përshkruar observimet e tij duke përfshirë fotografitë. Vlerësimi i menjëhershëm është siguruar nga Dr. B.. Dëshmia e saj në gjykatë është plotësisht e besueshme sa i përket të gjitha lëndimeve.

10. Kredibiliteti i dëshmitarit B

⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 11 gusht 2014, faqe 22, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17 nëntor 2014, faqe 6

Dëshmitari B është edhe një dëshmitar primar, i cili pohon se ka është rrah së bashku me Dëshmitarin A. Dëshmia e tij para gjykatës është refuzuar për shkak të rindërtimit të fakteve. Ky konkluzion është bazuar në vërejtjet e trupit gjykues, se dëshmitari B a qenë i frikësuar dukshëm me e treguar të vërtetën.

Paneli pajtohet me vlerësimin e gjykatës së instancës së pare dhe e ndryshon vlerësimin e saj.

Është vërejte se dëshmitari B para gjykatës e ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme qëndrimin e tij në krahasim me fazën e procedurës paraprake. Për arsyet e lartpërmendura, deklaratat e tij gjatë procedurës paraprake janë nuk janë pranuar si prova direkte. Dëshmia e tij në gjykatë nuk ka qenë e besueshme dhe bindëse. Arsyet e një vlerësimi të tillë mund të gjenden jo në kundërshtimin e deklaratës së tij me dëshmitë e tij në krahasim me dëshmitarët A dhe K siç është paraqitur në pikën 147 të aktgjykimit të kundërshtuar, por më shumë në kundërshtimin e deklaratave të tij mes vete. Dëshmitari B ka dhënë dëshmi të përsëritura në lidhje me këtë lëndë në fjalë. Atij i është kërkuar me i sqaruar kundërshtimet të cilat janë paraqitur, por në vend të sqarimeve ai i ka mohuar deklaratat e tij, të cilat janë regjistruar gjatë marrjes në pyetje të tij të mëhershme para gjykatës. Gjatë tërë sjelljes së tij para gjykatës ai e ka shprehur frikën për sigurinë e tij dhe të familjes për shkak të dëshmisë së tij⁶. Ai gjithashtu i ka shpallur të pandehurit si armiq të tij. Ky qëndrim e ilustron qartë hezitimin e tij për të dhënë një dëshmi të plotë dhe të sinqertë dhe me u përputhur me detyrën për të gjetur të vërtetën.

11. Gjetjet e fakteve

Pas vlerësimin të provave në bazë të ankesave, Paneli ka përfunduar se ngjarjet të cilat kanë ndodhur në Likoc gjatë paraburgimit të Dëshmitarit A janë dëshmuar nga dëshmia e Dëshmitarit A në bashkëpunim me dëshminë e dëshmitarit K dhe dëshmitarit ekspert Dr. C.B.. Paneli e thekson se standardi i bashkëpunimit nuk kërkon që secila pjesë e deklaratës së dëshmitarit kryesor të vërtetohet. Në situata kur dëshmia e tij është vërtetuar nga dëshmitarët e tjerë në disa pjesë, e tërë deklarata e një dëshmitari të tillë mund të jetë bazë për caktimin e dënimit. Paneli pajtohet me pohimet e Dëshmitarit A si të besueshme dhe deklarata e tij është bazë e mjaftueshme për konkluzionet e gjykatës.

Në bazë të kësaj është dëshmuar se të pandehurit i kanë kryer veprat e përshkruara në të dy akuzat në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar. Rrahja e Dëshmitarit B së bashku me Dëshmitarin A është dëshmuar me deklaratën e Dëshmitarit A, i cili i ka përshkruar rrahjet e të dy viktimave në të njëjtin vend dhe të njëjtën kohë. Kundërshtimi i ankimesit në lidhje me mungesën e padisë civile të dëshmitarit A dhe B në lidhje me dëmet e pësuar nga rrahja janë të parëndësishme, pasi që padia civile është e drejtë e palës së dëmtuar pa asnjë ndikim në meritat e rastit penal.

⁶ Proceverbali i shqyrtimit gjyqësor më 9 dhjetor 2014 faqe 3, faqe 4, faqe 10

12. Ligji substancial i zbatueshëm

Trupi gjykues i ka kushtuar vëmendje të gjerë kësaj çështjeje. Gjetjet e tij janë sqaruar në pikat 204 – 242 të aktgjykimit të kundërshtuar. Konkluzionet megjithatë nuk janë të qarta, pasi që në dispozitiv të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013 është përdorë së bashku me Kodin Penal të RSFJ-së. Prandaj paneli ka vlerësuar ligjin substancial të zbatueshëm në vetvete.

Neni 3 i KPRK, Kodi në fuqi gjatë procedurës penale, parasheh:

- 1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.*
- 2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.*

Më 1998 kur veprat e të pandehurve janë paditur se janë kryer, Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1977 (LPRSFJ) ka qenë në fuqi, i ndryshuar me Kushtetutën e RFJ më 1992, i cili e ka anuluar përdorimin e dënimit me vdekje.

Në ndërkohë Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) i vitit 2004 ka qenë në fuqi, efektiv nga 6 prilli 2004.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Vlerësimi i ligjit më të favorshëm nuk mund të bazohet në një krahasim të thjeshtë të llojeve të dënimeve të parapara. Vlerësimi i ndikimit të tërë të zbatimit të një kodi të caktuar dhe të merret parasysh. Përveç kësaj, vlerësimi nuk mund t'i shqyrton as mundësitë teorike të dhëna me ligj, por duhet të merret parasysh situata konkrete e të pandehurit.

Në bazë të aktakuzës, të pandehurit janë akuzuar për veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile të kryera në bashkëpunim në bazë të neneve 22 dhe 142 të LPRSFJ (aktualisht i penalizuar me nenet 31 dhe 152 të KPRK).

Neni 142 i LPRSFJ parasheh:

Kushdo që shkel rregullat e të drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë qenë në fuqi në kohë të luftës, konfliktit të armatosur apo urdhrave të okupimit që popullata civile t'i nënshtrohet vrasjeve, torturave, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjeve të pamasë apo shkelej të integritetit trupor apo shëndetit [...] apo kushdo që kryen njëri prej veprave në vijim, dënohet me burgim për jo më pak se pesë vjet apo ne dënim me vdekje.

Neni 38 i LPRSFJ parasheh:

- 1. Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se 15 vjet.*

2. *Gjykata mund të cakton dënimin me burgim prej 20 vjet për veprat penale të cilat janë të pranueshme për dënim me vdekje.*

LPRSFJ-së nuk e jep asnjë përkufizim të *popullatës civile*. Paneli i konteston konkluzionet e trupit gjykues të paraqitura në pikat 216 – 219, se civilët individual nuk jnaë mbuluar nga mbrojtja në nenin 142 të LPRSFJ-së.

Komentari i nenit 142 të LPRSFJ-së parasheh si në vijim:

Popullata civile është viktima e një veprimi penal. Mbrojtja penale ligjore përfshin të gjithë civilët në territorin e okupuar ...].⁷

Paneli përfundon se formulimi “*të gjithë civilët*” duhet të kuptohen si “kushdo prej civilëve”.

Kodi përveç kësaj i referohet *rregullave të drejtës ndërkombëtare që është në fuqi në kohë të luftës*. Ky formulim e lejon njohjen ligjore të çfarëdo zhvillimi të drejtës ndërkombëtare pa pasur nevojë me ndryshuar legjislacionin vendor. Neni i përbashkët 3 i Konventës së Gjenevës i mbulon civilët individual dhe ata të cilët janë *hors de combat*. Prandaj Paneli është i mendimit se kryesit e akteve të përshkuara nga Dëshmitari A, janë penalisht të përgjegjshëm në bazë të nenit 142 të LPRSFJ-së .

Siç është përmendur më lartë , Kushtetuta e vitit 1992 e ka anuluar përdorimin e dënimit me vdekje në ish Jugosllavi. Ky fakt duhet të konsiderohet kur të vlerësohet ligji më i favorshëm. Anulimi i dënimit me vdekje megjithatë nuk ndikon në nenin 38 siç është cituar më lartë, pasi që në dispozita e tij “ *e drejta për dënimin me vdekje* “ e përfaqëson vetëm peshën e aktit kriminal.

KPP në nenin 120 paragrafi 1, parasheh:

Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

Neni 37 paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) parasheh:

Burgimi afatgjatë shqiptohet në kohëzgjatje prej njëzet e një deri në dyzet vjet.

KPP në nenin 152 paragrafin 1 parasheh:

Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.

⁷ Ljubisa Lazarevic; Komentari i Kodit Penal të RFJ-së ; 1995; Botimi 5^{të}; Administrata Bashkëkohore , Beograd; Neni 142; pika 3

Neni 44 i KPRK parasheh:

Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.

Duke i krahasuar renditjen e thjeshte të dënimeve të cilat janë të zbatueshme, dënimet më të buta, më të favorshme për të pandehurit, janë paraparë në LPRSFJ-së. Siç është përmendur më lartë vlerësimi i ligjit më të favorshëm duhet të merr parasysh të gjitha pasojat të cilat vijnë nga zbatimi i tij.

KPRK, për dallim prej dy Kodeve tjera, e parasheh në Nenin e tij 81, konceptin e veprës penale në vazhdim. Nga përkufizimi, vepra penale në vazhdim ekziston, kur ekzistojnë së paku dy prej kushteve në vijim:

1. viktimës së njëjtë të veprës penale;
2. objekti i njëjtë i veprës;
3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore;
4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe
5. dashja e njëjtë e kryesit.

Përfshirja është definuar në paragrafin 2, si në vijim:

Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person.

Paneli është i mendimit se në rastin në fjalë në lidhje me të pandehurit S.S., J.D., Z.D. dhe I.T., ky koncept është i zbatueshëm sa i përket rrahjes së Dëshmitarit A. Aktet e shumta të rrahjes janë kryer nga e kryesve të njëjtë, kundër së njëjtës viktimë (Dëshmitarit A), duke përfutur nga e njëjta situatë (robërisë së viktimës) në të njëjtin vend (objekti i UÇK-së në Likoc)⁸ udhëhequr nga i njëjti qëllim i kryesve të veprës (për ta dënuar një kolaborator të mundshëm). Sa i përket këtyre katër të pandehurve, KPRK i fundit është ligji më i favorshëm, pasi që cilido prej Kodeve të kaluara nuk e përcaktojnë një koncept të tillë dhe zbatimi i tij është më i favorshëm për të pandehurit po qe se krahasohet me përdorimin e dënimit unik.

Sa i përket të pandehurve tjerë, Paneli vlerëson se janë caktuar dënime të zbutura nën kufirin minimal të paraparë me ligj. Krahasimi në mes të dispozitave, që përfshin një ndëshkim më të butë, është pra i nevojshëm.

KPRSFJ në Nenin 43 lejon uljen e dënimit nën kufirin për dënime vetëm kur kufiri më i ulët nuk është më i lartë se tre vjet. Në rastin në fjalë, reduktimi i dënimit nën minimumin e paraparë nuk

⁸ Trupi gjykues është i mendimit se objekti i UCK-se në Likoc duhet që të konsiderohet si një vend sipas Nenit 81, paragrafi 1, nen-paragrafi 1.4 i KPRK-se. Dhoma e posaçme e ndërtesës nuk është një vend tjetër në kontekst të burgimit të vazhdueshëm të dëshmitarit A në tere objektin.

është i mundshëm, ndërsa në KPPK-së, në Nenin 67, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 thotë *Nëse për veprën penale është paraparë dënimi me burgim afatgjatë, dënimi mund të zbutet deri në dhjet vjet burgim*, dhe KPRK në nenin 76, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 thotë *nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku pesë (5) vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) vjet burgim*.

Duke i krahasuar normat e cituara më sipër, konkludimi mbi dispozitën më të favorshme, është se është ajo e KPRK-së së fundit.

13. Identifikimi i kryesve

Mbrojtja e ka sfiduar dispozitivin e aktgjykimi të instancës së parë për shkak të faktit se aktet e kryera janë përshkruar vetëm në mënyrë të përgjithshme, pa bërë ndonjë dallim të ndonjë akti në veçanti të ndonjë të pandehuri në veçanti.

Nga natyra e akteve të kryera nga kryesit është e qartë, sjellja specifike e të pandehurve të veçante vështirë se mund të dallohet. Megjithatë është dëshmuar se të gjithë të pandehurit kanë marrë pjesë në dhunën e përshkruar në dispozitiv, kështu që vepra penale është kryer nga të gjithë ata së bashku. Pjesëmarrja e tyre prandaj i përmbush kushtet për bashkëkryerjen në bazë të nenit 31 të KPRK, të definuar si më poshtë:

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale.

Edhe pse kjo është e padiskutueshme se përgjegjësia penale është gjithmonë personale ose e individualizuar, në rastin në fjalë është dëshmuar se të gjithë të pandehurit ishin prezent kur është kryer vepra penale dhe të gjithë ata kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në kryerjen e saj. Identifikimi individual i të pandehurve është bazuar në njohurinë personale të Dëshmitarit A, i cili padyshim se i ka njohur të gjithë vëllezërit D. dhe D. si fqinj të tij. Sa i përket S.S., ai e ka njohur atë për shkak të kontakteve personale gjatë kapjes së tij në Likoc. Sa i përket I.T., ai e kishte njohur atë si kushëri të familjes D. dhe i ka dëshmuar vizitat e tij në shtëpinë e D. para luftës.

Rrethanat e mëvonshme janë të rëndësishme në kontekst të kundërshtimit nga ankuesit sa i përket identifikimit të I.T. para gjykatës. Mbrojtja i referohet nenit 120 të KPP. Gjykata e instancës së parë e kishte dhënë përgjigjen në pikën 49 të aktgjykimit të tij. Paneli

Paneli në përgjithësi pajtohet me instancën e parë shprehimisht, se identifikimi i të pandehurit para gjykatës nuk është rregulluar me dispozitat e nenit 120. Paneli pajtohet se në fakt nuk ishte identifikimi i cili ka çuar drejt njohjes së një personi, por më shumë ka qenë konfirmimi i personit të përshkruar në deklaratat e dëshmitarit. I pandehuri si një individ i cili ka qenë i përfshirë në aktet e treguara nga deklaratat e Dëshmitarit A, është identifikuar në fazën e

procedurës paraprake dhe aty nuk ka pasur dyshime në lidhje me identitetin e tij në fazën e gjykimit.⁹

Duke u bazuar në këtë Paneli është i bindur, se që të dyja, edhe përshkrimi i aktit edhe identifikimin i kryesve është sa më i saktë që është e mundur dhe është dhënë një bazë ligjore për dënimin e të gjithë të pandehurve.

Sa i përket kualifikimi t ligjor të Panelit-duke iu referuar konkluzioneve siç janë paraqitur më lartë- e ka sqaruar ligjin e zbatueshëm. Duhet të përmendet se gjykata e instancës së parë e ka zbatuar në mënyrë të saktë dispozitat e KPRK. Gjykata e instancës së parë, megjithatë ka gabuar duke e përmendur LPRSFJ-së përgjatë, gjë që e ka bërë dispozitivin. Paneli e ka eliminuar këtë paqartësi.

14. Vepra penale në vazhdim

Përkufizimi i veprës në vazhdim, siç është përcaktuar në Nenin 81 të KPRK është dhënë më lartë. Zbatimi i këtij koncepti është relevant për rastin e të pandehurve S.S., J.D., Z.D. dhe I.T.. Paneli plotësisht pajtohet me aplikimin e tij për aktet e pikës II të aktgjykimit të kundërshtuar. Megjithatë, Paneli është i mendimit se Trupi gjykues i shkallës së parë ka gabuar që nuk e ka zbatuar këtë edhe për akuzën I.

Akti i Akuzës I është kryer ndaj dëshmitarëve A dhe B. Sa i përket Dëshmitarit A nuk ka dallime faktike të cilat vijnë nga prezenca e një viktime tjetër në vendin e ngjarjes. Sa i përket atij, ka qenë një ngjarje tjetër e rrahjes në zinxhirin e gjatë të ngjarjeve të tilla gjatë paraburgimit të tij. Rrahja e tij nga këndvështrimi i kryesve nuk dallon gjithashtu. Ai ka qenë viktimi e njëjtë si në rrahjet e kaluara, shëndeti dhe integritetit i tij njerëzor i janë nënshtruar veprës penal të njëjtë, kryesit e kanë shfrytëzuar të njëjtën situatë-duke e mbajtur Dëshmitarin A në paraburgim, vendi i veprës penale ka qenë i njëjtë – lokacioni në Likoc, dhe qelli i kryesve ishte i njëjte – me e “dënuar” “ bashkëpunëtorin e Serbëve” të pretenduar. Përgjashtimi prej vazhdimit siç është definuar në paragrafin 2 te nenit 81 nuk vlen, sa i përket Dëshmitarit A, vepra është kryer kundër të njëjtit person.

Prandaj Paneli përfundon se veprat e kryera nga katër të pandehurit të përmendur në të dy rastet kualifikohen si vepra penale në vazhdim.

15. Përcaktimi i dënimeve

Gjykata e instancës së parë e ka përshkruar vlerësimin e tij të dënimeve më shkurtimisht në pikat 251–262 të aktgjykimit të kundërshtuar.

Paneli thekson se kur gjykata e bën aplikimin e konceptit të veprave penale në vazhdim, nuk ka nevojë që dënim unik – sikur kur shqiptohen ndaras për secilën akuzë si në bashkëveprim të tërësishëm të veprave penale[*sic*].

⁹ Proceverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17 nëntor 2014 faqe 30, po ashtu në lidhje me identifikimin e I.T., procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 15 shtator 2014 faqe 21-23.

Ndonëse përcaktimi i dënimeve duhet të individualizohet rreptësisht, Paneli pajtohet me mendimin e gjykatës së instancës së parë se ekzistojnë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund t'i aprovohen të gjithë të pandehurve apo disave.

Si faktor lehtësues që mund t'i aprovohet të gjithë të pandehurve është jeta e sinqertë pas luftës. Paneli nuk ka mundur të njeh luftën kundër regjimit të ish Jugosllavisë në kohën e kryerjes së veprës penale si faktor lehtësues, pasi që ky fakt nuk ka ndikim lehtësues në veprën e kryer. Në të kundërtën, konflikti i armatosur në rastin në fjalë është keqpërdorë pasi që skenat e dhunshme janë kryer kundër njerëzve që nuk kanë pasur lidhje të drejt për drejt me luftën. Sjellja e kryesve si pjesëtarë të palës në konflikt, është një element i definimit të kriminit të luftës, kështu që nuk mund të konsiderohet që të jetë si faktor lehtësues. Paneli po ashtu i konteston pozitat politike të rëndësishme apo punën prestigjioze si faktor lehtësues në këtë rast. Këto pozita nuk kanë ndikuar në asnjë mënyrë në peshën apo sjelljen e tyre kriminale gjatë kohës së luftës.

Sa i përket rrethanave rënduese paneli pajtohet me pikën 253 të aktgjykimit të kundërshtuar, duke ia pranuar kohën e vazhduar të trajtimit mizor të Dëshmitarit A në akuzën II. Shkelja mizore e integritetit njerëzor e kryer duke i urdhëruar Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B me e rrahur njëri tjetrin nuk është individualizuar për asnjërin prej të pandehurve. Në bazë të gjetjeve faktike, kjo rrethanë duhet që të konsiderohet si rënduese për të pandehurin I.T., i cili sipas deklaratës së Dëshmitarit A i ka urdhëruar personalisht të dy dëshmitarët për të rrahur njëri tjetrin. Edhe një faktor rëndues që ka të bëjë me I.T. është; mënyra e rrahjes së viktimave. Dëshmitari a ka theksuar se ka qenë I.T., ai i cili e ka përdorë shkopin e drurit dhe e ka kryer rrahjen në mënyrën më mizore¹⁰.

Një faktor tjetër specifik rëndues është vënë re nw lidhje me të pandehurin S.S.. Siç është dëshmuar me provën¹¹ ai ka qenë komandant i zonës operative të UÇK-së në Drenicë. Nga radha e të gjithë të pandehurve, ai e ka pas gradën më të lartë. Përveç fuqisë së tij zyrtare dhe përgjegjësie, ai e ka mbajtur një sjellje të konsiderueshme të butë si shembull i sjelljes për anëtarët tjerë të UÇK-së. Duke vepruar si kryes i shkeljes të kryer kundër të burgosurve, ai e ka mundësuar vendimin e të tjerëve për të përcjellë atë në sjelljet e tij. Ndonëse nuk ka prova që ai në mënyrë të qartë i ka urdhëruar të tjerët për të rrahur të burgosurit në këtë rast dhe përgjegjësia e tij e komandimit është prapa fushës së akuzave që kanë të bëjnë me këtë rast, roli i tij si një autoritet i pakontestueshëm që ka marrë pjesë drejt për drejt në kryerjen e veprës duhet që të konsiderohet si rëndues.

Sa i përket vlerësimit të lartpërmendur të sjelljes individuale të pandehurve S.S., I.T., J.D. dhe Z.D., gjykata përcakton dënimet siç janë paraqitur në dispozitiv.

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 12 gusht 2014 faqe 12,
Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17 nëntor 2014 faqe 13, faqe 19

¹¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 12 gusht 2014 faqe 9

Asnjë rrethanë tjetër specifike rënduese nuk është marrë në konsideratë sa i përket të gjashtë të pandehurve të tjerë. Të gjithë prej tyre kanë marrë pjesë në ngjarjen e rrahjes. Përveç faktit se është maltretuar më shumë se një viktimë gjatë asaj nate, dhe dhuna dhe mizoria kanë qenë të konsiderueshme, Paneli është i mendimit se nga radha e dënimeve të zbatueshme për krime lufte, dënimet e zbutura nën kufirin e paraparë me ligj mjaftojnë për të arritur qëllimin e tyre. Dënimi prej tre vjetësh me dënim është minimumi më i ulët sipas nenit 76 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i KPP. Paneli nuk e ka njohur asnjë rrethanë individuale e cila do të rezultonte në përcaktimin e një dënimi më të rëndë, për asnjërin prej të pandehurve.

E tërë periudha e kaluar në paraburgim nga cilido prej të pandehurve është llogaritur në dënimet e tyre.

16. Kostoja e procedurave

Në rastin e shpenzimeve të procedurës penale, gjykata e instancës së parë i ka urdhëruar të pandehurit me kompensuar në shumën e cila është proporcionale me peshën e veprave të tyre penale. Trupi gjykues nuk ka dhënë asnjë arsye, se përse J.D. ka urdhëruar kompensimin e shumës e cila e zgjeron gjerësisht logjikën e vendimit. Paneli e ka korrigjuar mosbalancimin e përmendur.

A. Fjalitë përmbyllëse

Sa i përket aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit për arsyet e lartshënuara:

I refuzon të gjitha ankesat në emër të pandehurve dhe Prokurorisë. Vendimi i shpalljes fajtor për akuzën I dhe II të aktgjykimit të kundërshtuar është konfirmuar;

Paneli e ka zbatuar konceptin ligjor të veprës penale në vazhdim në akuzat I dhe II, sa i përket të pandehurve S.S., I.T., Z.D. dhe J.D.;

Si pasojë e kësaj, Paneli i ka modifikuar dënimet;

Paneli saktësisht e ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, në periudhën e dënimit,

Dhe pjesërisht i ka ri-llogaritur shpenzimet e procedurave penale.

I përpiluar në gj. Angleze si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi është arsyetuar më 7 tetor 2016.

Kryetar i trupit gjykues

Roman Raab
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i panelit

Jorge Martins Ribeiro
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i panelit

Hava Haliti
Gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Kosovë

Procesmbajtës

Adam Viplak
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
PAKR 456/15
14.09.2016

